



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

PUNIM MAGJISTRATURE

**“Analizë krahasimore e raporteve financiare në sektorin e minierave në
Maqedoninë e Veriut.**

**Rast studimor i ndërmarrjeve „ALMACO MINERALS, VOLOSTONE dhe
FIMAR BALKAN,,**

MENTOR:

Prof.Dr.Rufi OSMANI

KANDIDATI:

Amra Bushi-Mjaki

Shkup, 2022

DEKLARATË

Unë, Amra Bushi-Mjaki studente në studimet postdiplomike në Fakultetin të Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë, deklaroj se ky punim masteri është punë hulumtuese e imja dhe se nuk është publikuar më parë nga autorë të tjerë. Çdo material që kam përdorur është deklaruar në tekst me referencë përkatëse dhe bibliografia përmban të gjithë literaturën që kam përdorur gjatë gjithë punës sime hulumtuese.

Jam i vetëdijshëm se çdo shkelje e rregullave të caktuara do të rezultojë me anulimin e këtij studimi empirik.

Përmbajtje

Abstrakt.....	6
Абстракт.....	7
Abstract.....	8
Falenderime dhe mirënjohje	9
KAPITULLI I – Hyrje	10
1.1. Lënda e hulumtimit.....	10
1.2. Qëllimi i hulumtimit	11
1.3. Hipotezat.....	12
1.4. Metodologjia.....	12
1.5. Rëndësia e punimit.....	13
KAPITULLI II – Rishikimi i literaturës	14
2.1. Koncepti i analizës financiare.....	14
2.1.1. Raportet financiare si bazë e analizës financiare	15
2.1.2. Bilanci i gjendjes si objekt i analizës financiare	16
2.1.3. Bilanci i suksesit si objekt i analizës financiare.....	16
2.2. Analiza vertikale	17
2.3. Analiza horizontale	19
2.4. Treguesit financiar	20
2.4.1. Treguesit e likuiditetit	20
2.4.2. Treguesit e levës financiare.....	23
2.4.4. Treguesit e profitabilitetit.....	25
Kreu III – Analiza horizontale, vertikale dhe racio analiza në sektorinë e minierave në Maqedoninë e Veriut.....	29
3.1. Analiza horizontale e Bilancit të Gjendjes dhe Bilancit të Suksesit në sektorin e minierave (2020-2017) në mënyrë individuale dhe të përbashkët dhe interpretimi rezultateve.....	29
3.1.1. Analiza horizontale e Volostone për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit	31
3.1.1.1. Analza horizontale e ndërmarrjes Voloston për Bilancin e Gjendjes.....	31
3.1.1.2. Analza horizontale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Suksesit.....	33
3.1.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Fimar	34
3.1.2.1. Analza horizontale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Gjendjes.....	34

3.1.2.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Suksesit.....	35
3.1.3. Analiza horizontale e ndërmarrjes Almarco.....	37
3.1.3.1. Analza horizontale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes	37
3.1.3.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes	38
3.2. Analiza vertikale e Bilancit të Gjendjes dhe Bilancit të Suksesit në sektorin e minierave (2020-2017) në mënyrë individuale dhe të përbashkët dhe interpretimi rezultateve.....	39
3.2.1. Analiza vertikale e Volostone për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit	41
3.2.1.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Gjendjes	41
3.2.1.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Suksesit.....	42
3.2.2. Analiza vertikale e Fimar për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit	43
3.2.2.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Gjendjes	43
3.2.2.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Suksesit.....	44
3.2.3. Analiza vertikale e Almarco për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit.....	47
3.2.3.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes	47
3.2.3.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Suksesit	48
3.3. Racio analiza në Minierat e Republikën e Maqedonisë së Veriut	49
3.3.1. Likuiditeti në sektorin e minierave.....	49
3.3.1.1. Likuiditeti i ndërmarrjes Volostone.....	49
3.3.1.2. Likuiditeti i ndërmarrjes Fimar.....	50
3.3.1.3. Likuiditeti i ndërmarrjes Almarco	51
3.3.2. Treguesit e strukturës financiare të sektorit të minierave	53
3.3.2.1. Treguesit e strukturës financiare për ndërmarrjen Volostone	54
3.3.2.2. Treguesit e strukturës financiare për ndërmarrjen Fimar	55
3.3.2.3. Treguesit e strukturës financiare për ndërmarrjen Almarco.....	56
3.3.2.4. Struktura kumulative financiare e sektorit të minierave	57
3.4. Analizë e treguesve të rentabilitetit.....	58
3.4.1. Norma e kthimit nga aktivet në sektorin e minierave (ROA)	58
3.4.1.1. Norma e kthimit të aktiveve për ndërmarrjen Volostone.....	59
3.4.1.2. Norma e kthimit të aktiveve për ndërmarrjen Fimar.....	59
3.4.1.3. Norma e kthimit të aktiveve për ndërmarrjen Almarco	60
3.4.2. Norma e kthimit nga kapitali në sektorin e minierave (ROE).....	61

3.4.2.1.	Norma e kthimit të kapitalit për ndërmarrjen Volostone	62
3.4.2.2.	Norma e kthimit të kapitalit për ndërmarrjen Fimar	62
3.4.2.3.	Norma e kthimit të kapitalit për ndërmarrjen Almarco.....	63
Kreu IV.	Përfundime dhe rekomandime	65
4.1.	Përfundime.....	65
4.2.	Rekomandime.....	66
4.3.	Kufizimet.....	67
Kreu V –	Shtojca.....	69
	Bilanci i Gjendjes për ndërmarrjen Volostone 2016-2020.....	69
	Pasqyra e të ardhurave për ndërmarrjen Volostone 2017-2020	70
	Bilanci i Gjendjes për ndërmarrjen Fimar Balkan 2016-2020	71
	Pasqyra e të ardhurave për ndërmarrjen Fimar Balkan 2016-2020.....	73
	Bilanci i Gjendjes për ndërmarrjen almarco 2016-2020	74
	Pasqyra e të ardhurave për ndërmarrjen almarco 2016-2020.....	75
	Literatura e shfrytëzuar	76

Abstrakt

Qëllimi kryesor i përpilimit të raporteve financiare është të ofrojë informacion për grupet e ndryshme të interesit që mbështeten në to në procesin e vendimmarrjes, sepse ato përfshijnë të gjitha ngjarjet financiare që lindin si brenda kompanisë, ashtu edhe nga marrëdhëniet e shoqërisë me të tretët. Rëndësia e pasqyrave financiare në kushtet që kanë ndryshuar në krahasim me periudhën e disa dekadave më parë është bërë edhe më e theksuar.

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë faktin se analiza financiare nuk përfundon me llogaritjen e raporteve të duhura, por vlerat e tyre duhet të analizohen dhe krahasohen me standarde apo qëllime të përcaktuara. Pas krahasimit dhe identifikimit të devijimeve, është e nevojshme të zbatohen masa korrigjuese për të arritur qëllimet e përcaktuara.

Ky punim bën qasje empirike dhe analizë krahasimore për tre ndërmarrje që aktivitetin e tyre kryesor e kanë përpunimin dhe nxjerrjen e xeheve dhe mineraleve apo më konkretisht thënë sektorin e minierave edhe atë: Volstone, Fimar Balkan dhe Almarco Minerals për periudhën kohore 2017 - 2020.

Supozimet fillestare janë se ekziston një asimetri ndërmjet financimit të pasurisë nga burimet vetanake nga njëra anë dhe borxhi i kompanisë nga ana tjetër. Struktura mjaft e ndryshme e financimit sjellë asimetri të normave të aktivitetit dhe profitabilitetit përgjatë periudhës që kryhet hulumtimi. Kjo nga ana tjetër manifestohet me nivele të ulëta të likuiditetit dhe solvenitetit.

Përmes analizës së raporteve financiare të këtyre tre ndërmarrjeve tentohet që të nxjerret edhe një pasqyrë e përgjithshme për sektorin e minierave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe qasjen/problemet dhe sfidat e tyre të financimit dhe menaxhimit financiar.

Fjalë kyçe: Analiza financiare, raporte financiare, normat financiare, sektori i minierave.

Абстракт

Основната цел на составувањето на финансиските извештаи е да се обезбедат информации за различните групи од интерес кои се потпираат на нив во процесот на одлучување, бидејќи тие ги вклучуваат сите финансиски настани кои произлегуваат и во рамките на компанијата и од односите на компанијата со трети лица. Значењето на финансиските извештаи во условите што се сменија во однос на периодот од пред неколку децении стана уште поизразено. Целта на овој труд е да се истакне фактот дека финансиската анализа не завршува со пресметката на соодветните коефициенти, туку нивните вредности мора да се анализираат и споредат со дефинирани стандарди или цели. По споредбата и идентификувањето на отстапувањата, неопходно е да се спроведат корективни мерки за постигнување на дефинираните цели.

Овој труд прави емпириски пристап и компаративна анализа за три компании чија основна дејност е преработка и екстракција на руди и минерали или поконкретно рударскиот сектор: Volstone, Fimar Balkan и Almarco Minerals за период 2017 - 2020. Првичните претпоставки се дека постои асиметрија помеѓу финансирањето на капиталот од сопствено извори од една страна и долгот на компанијата од друга страна. Многу различната структура на финансирањето води до асиметрија на стапките на активност и профитабилноста во текот на периодот додека се спроведува истражувањето. Ова пак се манифестира со ниски нивоа на ликвидност и солвентност.

Преку анализата на финансиските извештаи на овие три компании, се прави обид да се изведе општ преглед на рударскиот сектор во Република Северна Македонија и нивниот пристап/проблеми и предизвици во финансирањето и финансиското управување.

Клучни зборови: Финансиска анализа, финансиски норми , рударство, финансиски извештаи

Abstract

The main purpose of compiling financial reports is to provide information to the various interest groups that rely on them in the decision-making process, because they include all financial events that arise both within the company and from the company's relations with third parties. The importance of financial statements in the conditions that have changed compared to the period of several decades ago has become even more pronounced.

The purpose of this paper is to highlight the fact that the financial analysis does not end with the calculation of the appropriate ratios, but their values must be analyzed and compared with defined standards or goals. After comparing and identifying deviations, it is necessary to implement corrective measures to achieve the defined goals.

This paper makes an empirical approach and comparative analysis for three companies whose main activity is the processing and extraction of ores and minerals, or more specifically the mining sector: Volstone, Fimar Balkan and Almarco Minerals for period 2017 - 2022.

The initial assumptions are that there is an asymmetry between equity financing through own sources on the one hand and company debt on the other. The very different structure of financing leads to asymmetry of activity rates and profitability throughout the period that the research is carried out. This in turn manifests itself with low levels of liquidity and solvency.

Through the analysis of the financial reports of these three companies, an attempt is made to derive a general overview of the mining sector in the Republic of North Macedonia and their approach/problems and challenges of financing and financial management.

Keywords: Financial analysis, financial reports, financial ratio, mining sector.

Falenderime dhe mirënjohje

Pikë së pari dua të falënderoj familjen time për përkrahjen e rezervë të tyre si morale ashtu dhe financiare. Falenderoj prindërit dhe bashkëshortin pa të cilët realizimi i këtij punimi as që do të paramendohej.

Një falenderim i veçantë i takon mentorit tim Prof.d-r. Rufi Osmanit për propozimin e kësaj teze të magistraturës dhe për udhëzimet dhe mbështetjen gjatë përgatitjes së saj. Faleminderit për durimin mbi të gjitha dhe këshillat. Këshillat dhe sygjerimet e tij gjatë këtij e tejkalojnë aspektin formal të punimit dhe marrin trajtë shumë më të rëndësishme dhe qenësore.

Falenderimi i takon gjithashtu profesorëve të fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë pranë UEJL-it, kolegëve, shoqërisë dhe të gjithë personave të tjerë që më kanë mbështetur gjatë kësaj periudhe të studimeve postdiplomike.

Falenderim i veçantë shkon edhe për sektoret e financave dhe të kontabilitetit të ndërmarrjeve Volostone, Fimar Balkan dhe Almarco Minerals për ofrimin e raporteve financiare dhe dhënies shtesë të informacioneve operative të cilat ishin të domodoshme për realizimin e këtij punimi.

Dua të shpreh mirënjohje edhe për gjithë ata që kontribuan në fillimin dhe realizimin me sukses të këtij rrugëtimi.

Përjetësisht mirënjohëse!

KAPITULLI I – Hyrje

1.1. Lënda e hulumtimit

Analiza e raporteve financiare aplikon metoda dhe teknika të ndryshme, me të cilat përfitohen rezultate shumë të rëndësishme për udhëheqjen e biznesit. Ajo paraqet treguesin kryesor për selektimin e investimeve dhe për kushtet dhe konsekuencat e ardhshme financiare, mjet diagnostifikues për përcaktimin e aktiviteteve investuese dhe operuese, si dhe vlerësues i vendimeve tjera menaxheriale.

Analiza e raporteve financiare e zvogëlon besimin tonë në supozimet, hamendjet, intuitat, dhe e kthen pasigurinë në vendimmarrje. Ajo nuk redukton nevojën për mendim nga ekspertët por krijon një bazë efektive dhe sistematike për të marrë vendime në biznes

Objekt i analizës financiare janë pasqyrat financiare që dalin nga kontabiliteti i shoqërisë nëpërmjet përfundimit të rregullt të të gjithë librave afariste. Pasqyrat financiare janë produkt i drejtpërdrejtë i Kontabilitetit Financiar dhe sistemit të raportimit financiar, i cili në thelbin dhe qëllimin e tij pasqyron ecurinë e shoqërisë për një periudhë të caktuar kohore, pozicionin e saj financiar dhe strukturor, si dhe pozicionin e likuiditetit në datën e zgjedhur të bilancit.

Qëllimi kryesor i përpilimit të pasqyrave financiare është të ofrojë informacion për palët e ndryshme të interesuara të cilët mbështeten në to në procesin e vendimmarrjes sepse ato përfshijnë të gjitha ngjarjet e biznesit që ndodhin si brenda kompanisë ashtu edhe nga marrëdhëniet e kompanisë me palët e treta.

Analiza e pasqyrave financiare mund të jetë instrumentarium i rëndësishëm i matjes së performancës së organizatës me metoda bashkekohore të analizave në struktur dhe të trendit, analizave historike dhe të ardhmerisë, gjetjes së ekuilibrit ekonomik dhe financiar, analizave krahasimore në nivel të degës dhe ekonomisë nacionale, matje të profitabilitetit, likuiditetit, solventitetit, bankrotit potencial dhe të treguesve të tjerë ekonomik dhe financiar.

Pikërisht lëndë e këtij punimi është analizë e pozitës financiare në sektorin e minierave dhe minarele duke analizuar si rast studimor ndërmarrjet Almaco Minerals, Volostone dhe Fimar , përmes të cilave do të fitojmë një pasqyre më të gjërë për tërë sektorin në përgjithësi.

Motivi i kësaj lënde të hulumtimit buron nga fakti se është e nevojshme analiza dhe vlerësimi profesional i kapaciteteve financiare të kompanive që operojnë në sektorin e minierave dhe që veprojnë në kushte jashtëzakonisht të trazuara në periudhën aktuale dhe që karakterizohen nga pasiguri dhe ndryshime të shpeshta e të papritura pasi që nga ana tjetër edhe potenciali i këtij sektori është jashtëzakonisht i madh.

Vlerësimi i treguesve financiar është shumë i rëndësishëm për çdo kompani, sepse vendimet e rëndësishme financiare merren në bazë të të dhënave të marra. Nëpërmjet këtij punimi do të masim performancën ekonomike dhe financiare të tre kompanive të minierave të cilat kanë pasuri të financuar me nivele të ndryshme të kapitalit dhe të borxhit.

Kjo matje e performancës do të mat strukturën e pasurisë, kapitalit dhe borxheve duke e analizuar në aspekt strukturor dhe dinamik dhe do të mat performancën cilësore duke matur likuiditetin, aktivitetin, solventitetin dhe profitabilitetin e kompanive në fjalë në një periudhë kohore afatmesme (2016-2020)

1.2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimet e hulumtimit mund të ndahen në qëllime shkencore, të veçanta dhe shoqërore.

Qëllimi shkencor i hulumtimit është të begatojë fondin teorik dhe shkencor të analizës së raporteve financiare në sektorin e minierave dhe mineraleve, me theks të veçantë tregun e Maqedonisë së Veriut, duke i marrë si rast studimor disa ndërmarrje si dhe t[përshkruajë të gjitha elementet, analizat dhe metodat e përdorura në procesin e analizës së pasqyrave financiare.

Qëllimi i veçantë i hulumtimit është të prezantojë elementet bazë të procesit të analizës së pasqyrave financiare dhe strukturën e tyre në mënyrë që të nxirret në sipërfaqe performanca ekonomike dhe financiare e këtij sektori mjfate specifik që janë objekt i hulumtimit të këtij punimi.

1.3. Hipotezat

Hipoteza nënkupton supozim që duhet vërtetuar ose hedhur poshtë. Funksionet e një hipoteze mund të shihen si ofrim i një shpjegimi ose parashikimi testues që nga ana tjetër lejon që hipoteza të testohet dhe të drejtohet në procesin e kërkimit.

Hipotezat e këtij punimi janë:

H1. Financimi i pasurisë nga burimet vetiake dhe nga borxhi në kompanitë e analizuar është mjaft asimetrik përgjatë periudhës së analizuar,

H2. Kompanitë e analizuar në këtë punim kryesisht kanë nivele të ulëta të likuditetit dhe solventitetit në periudhën e analizuar,

H3. Normat e aktivitetit dhe te profitabiliteti përgjatë periudhës së analizuar janë asimetrike si rezultat i strukturës mjaft të ndryshme të financimit të pasurisë së kompanive të analizuar.

1.4. Metodologjia

Në përputhje me natyrën e temës, qëllimet dhe hipotezat fillestare, do të zbatohet metodologjia e duhur në mënyrë që të plotësohen kërkesat themelore metodologjike - objektiviteti, besueshmëria, përgjithësimi dhe sistematika. Në këtë punim studimor do të shfrytëzohet një metodologji e tillë hulumtimi që nisët nga e konkretja tek e përgjithshmja.

Para së gjithash, punimi do të prezantojë një metodë kërkimore bazuar në analizën, përpunimin dhe sintezën e literaturës përkatëse profesionale, si të autorëve vendas ashtu edhe të huaj.

Në paraqitjen e treguesve dhe koeficienteve të ndryshëm që shprehin gjendjen financiare të kompanive të analizuar do të zbatohen metoda të caktuara matematikore. Metoda e krahasimit të treguesve të ndryshme do të tregojë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, si dhe nevojën për t'i kombinuar ato për të analizuar më mirë aftësinë kreditore.

Gjithashtu, do të zbatohet metoda komparative për të parë vlerat e bastisjeve në të dyja kompanitë e vëzhguara: Almarco Minerals, Volostone dhe Fimar Balkan. Që të fitohet një pasqyrë më e qarte dhe të analizohet trendi më objektivisht analiza e raporteve financiare për kompanite përkatëse do të bëhet për një periudhë 5 vjeçare, gjegjësisht 2016 – 2020. Për qëllimet

e këtij hulumtimi janë siguruar raportet financiare për të gjitha ndërmarrjes për periudhën e lartëshënuar.

1.5. Rëndësia e punimit

Ky punim ka rënësi se synon të tregoj performancën e kompanive në sektorin e minierave nëpërmjet treguesve standard të matjes së performancës ekonomike dhe financiare duke i krahasuar kompanit në periudhën e analizuar dhe në krahasim me mesataren e degës së minierave në nivele të ekonomisë së vendit.

Korelacioni i likuiditetit me profitabilitetin dhe aktivitetin e kompanive të analizuar në një periudhë 5 vjeçare periudhë në të cilën përfshihet edhe pandemia Covid-19 të punimit do të jetë analizë e dobishme për investitorët e interesuar në këto kompani sepse do të japë konkluzione më të mira se a vlen të investohet në këto kompani .

KAPITULLI II – Rishikimi i literaturës

2.1. Koncepti i analizës financiare

Analiza e pasqyrave financiare është një proces gjykimi që synon të vlerësojë pozicionin financiar të kaluar dhe atë të tashmin në një kompani. Objektivi parësor i saj është përcaktimi, parashikimi dhe vlerësimi më i mirë i kushtve ekonomike dhe performances në të ardhmen. Përpyekjet për të bërë një analizë financiare i shohim në çdo organizatë të pajisur me autonomi financiare, siç janë: shoqëritë tregtare, firmat, shoqatat e ndryeshme, institucionet publike, ato financiare, etj. Analiza e pasqyrave financiare është një metodë e krahasimit, gjykimit ose e vlerësimit të gjendjes së vlerave të pjesëve të catuara të bilanceve, në bazë të cilave merrren vendimet e rëndësishme. Pra, analiza financiare, është një analizë e bilanceve për të kaluarën, të tashmën dhe të ardhmën e ndërmarrjes.

Pikërisht për këtë arsye ndërmarrjet në vazhdimësi kanë nevojë për analiza me qëllim të detektimit të trendit dhe reagimin ndaj të njejtës.

Analiza kryhet me qëllim njohjen më të hollësishme të objektit të analizuar. Ajo duhet të jetë e besueshme, e saktë, por edhe uniforme, që do të thotë se të dhënat e kontabilitetit dhe të tjera duhet të përpilohen dhe paraqiten në përputhje me rregulloret aktuale dhe të jenë të sakta, korrekte dhe realiste. Analiza e biznesit kryhet për të marrë një vendim të përshtatshëm biznesi pas marrjes së të dhënave.¹

Bazuar në përmbajtjen e punës, shërbimi analitik i kompanisë i kryen këto detyra:

- a. mbledh detyrat e nevojshme për operationet e shoqërisë bazuar në treguesit kontabël dhe të tjerë (operativë dhe statistikorë) dhe raportet financiare (bilanci dhe pasqyra e të ardhurave);
- b. Sistematizon të dhënat e mbledhura për qëllime të analizës së operacioneve të shoqërisë,
- c. Krijon tregues të operacioneve të shoqërisë dhe nxjerr vlerësime globale i

¹ Peterson, P.P. and Fabozzi, F.J. (2012) Analysis of Financial Statements. 2nd Edition. John Wiley and Sons

- d. Paraqet për shqyrtim në organet drejtuese dhe drejtuese të shoqërisë tregues analitikë dhe konkluzione sintetike.²

Përmes këtij procesi bëhet matja e suksesit, vlerësimi i përparësive dhe dobësive të biznesit si dhe krahasimi i ndërmarrjes me veten për periudhën paraprake si dhe me industrinë në përgjithësi.³ Organizatat financiarisht të qëndrueshme janë të dëshirueshme për investitorët dhe përdoruesit e tjerë të jashtëm të informacionit financiar, sepse një biznes financiarisht i qëndrueshëm është ai që me sukses siguron aftësinë e tij për të gjeneruar të ardhura për investitorët, dhe të mbajë apo të rrisë vlerën e investimit të tyre.⁴

2.1.1. Raportet financiare si bazë e analizës financiare

Raportet financiare janë dokumente biznesi përmes të cilave kompania ofron informacion për rezultatet e transaksioneve të saj për përdoruesit brenda dhe jashtë saj. Rëndësia e raporteve financiare buron nga fakti se sistemi i kontabilitetit, brenda të cilit krijohen këto raporte, është i vetmi sistem i plotë i analizave numerike në kompani. Sigurisht, kjo nuk do të thotë se sistemi i kontabilitetit është i vetmi burim informacioni dhe se informacioni kontabël është i vetmi i rëndësishëm. Kjo do të thotë se ato janë të vetmet raporte të plota që përpilohen në baza të rregullta dhe që kanë karakter publik, dhe si të tilla janë të disponueshme për një gamë të gjerë përdoruesish.⁵

Në fillim të periudhës kontabël, pasqyrat financiare përshkruajnë atë me çka e fillon ndërmarrja. Të gjitha ndryshimet e biznesit gjatë vitit regjistrohen në sistemin e kontabilitetit për t'u sintetizuar në përfundimin vjetor në fund të vitit.

Analiza financiare përfshin përdorimin e pasqyrave të ndryshme financiare. Këto raporte janë: bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra dhe shënimet e flukseve të parasë. Menaxhimi i suksesshëm i politikës financiare të kompanisë nënkupton njohjen e mirë të këtyre raporteve.

² Siddiqui, S.A. (2006) Managerial Economics and Financial Analysis. New Age International

³ Gibson, C.H. (2010) Financial Reporting and Analysis: Using Financial Accounting Information. 12th Edition. Cengage Learning

⁴ Dr Bojović P., Dr Šikanić B., Dr Avakumović J., Dr Krasulja N., Mr Gujanica I., Mr Miletić M., Mr Senić V., Mr Rujan Z., Mr Avakumović J., Mr Grebović S., "Finansijska analiza poslovanja", Beograd, 2010., str. 30-31

⁵ Tsay.R.S., (2013). An Introduction To Analysis Of Financial Data With R. 1st ed. Hoboken: John Wiley & Sons, Inc.

2.1.2. Bilanci i gjendjes si objekt i analizës financiare

Bilanci tregon madhësinë dhe strukturën e aseteve dhe burimet e financimit. Në bilanc shohim aktivet, detyrimet dhe kapitalin e një shoqërie të caktuar. Struktura e fondeve, aktiveve, tregon mënyrën e investimit të mjeteve (aktiviteti investues), ndërsa struktura e burimeve të financimit, detyrimet, tregon efektet e aktivitetit financiar, pra strukturën financiare (konstituimin) e një shoqërie tregtare.⁶ Prandaj, ne mund të paraqesim bilancin duke përdorur një ekuacion bazë të modifikuar të kontabilitetit

$$\text{Aktiva} = \text{Detyrimet} + \text{Kapitali}$$

$$\text{Mjetet themelore} + \text{Mjetet qarkulluese} = \text{Detyrimet} + \text{Kapitali}$$

Bilanci si raport kontabël përmban një numër të madh informacionesh të ndryshme që përdoruesve u nevojiten për të përcaktuar pozicionin e tyre financiar. Megjithatë, ai informacion klasifikohet në grupe informacioni të ngjashëm për ta bërë më të lehtë për përdoruesit të gjejnë informacionin që u nevojitet. Informacioni që do të paraqitet në bilanc duhet të klasifikohet sipas kritereve specifike dhe të njohura.

Në praktikën e biznesit të shoqërive zbatohen kriteret e mëposhtme për klasifikimin e pozicioneve në bilanc:

- kriteri i rritjes së likuiditetit në aktive dhe zvogëlimit të maturimit të detyrimeve, i.
- kriteri i uljes së likuiditetit në aktive dhe rritjes së maturimit në pasive⁷.

2.1.3. Bilanci i suksesit si objekt i analizës financiare

Krahas informacionit mbi gjendjen financiare, për analistët dhe përdoruesit e analizës, është i nevojshëm edhe informacioni për suksesin (përfitueshmërinë) e operacioneve të kompanisë në periudhën kontabël. Ky informacion gjendet në bilancin e suksesit. Ndryshe nga bilanci i gjendjes, i cili tregon pozicionin financiar në një ditë të caktuar, bilanci i suksesit është një raport periodic. Kuptimi i këtij raporti qëndron në faktin se të ardhurat dhe shpenzimet tregohen për një periudhë të caktuar, kështu që diferenca e tyre (fitimi ose humbja) i referohet edhe asaj periudhe.

⁶ International Federation of Accountants, Handbook of International Auditing, Assurance, and Ethics Pronouncements, 2006 edition, p. 230, available at www.ifac.org.

⁷ Lee C Alice, Lee John, Lee C Cheng, Financial Analysis and Planning & Forecasting, World Scientific Publishing Co. Pte. Ltd., 2009. godine

Siç e kemi theksuar tashmë, nuk është e rëndësishme që nevojat e menaxhmentit efikas të paraqesin vetëm rezultatin e përgjithshëm (në fund të jetës së kompanisë), sepse ky lloj informacioni është i një cilësie të ulët (të pamjaftueshëm të përditësuar) për bazë për marrjen e vendimeve të biznesit. Në këtë kuptim, kur flasim për përpilimin e pasqyrës së të ardhurave, në fakt nënkuptojmë një raport financiar për një periudhë të caktuar kohore (një muaj, tremujor, gjysmë viti apo vit).⁸

Kompania nuk do të jetë në gjendje t'u kthejë fondet kreditorëve nëse ka arritur një rezultat financiar negativ dhe vëllimi është më i madh se fondet e veta të shoqërisë. Në raste të tilla biznesi, kompania humbi jo vetëm të gjitha fondet e veta, por edhe një pjesë të fondeve të njerëzve të tjerë⁹.

Diferenca ndërmjet të ardhurave totale dhe shpenzimeve totale paraqet fitimin, dhe diferenca ndërmjet shpenzimeve totale dhe të ardhurave totale paraqet humbjen e vitit të biznesit.

Bazuar në planet e miratuara më parë: vëllimi i shitjeve dhe prodhimit, stoqet fillestare dhe përfundimtare, kostot totale të fushave funksionale individuale të veprimtarisë, si dhe kostot mesatare totale variabile, përgatitet një pasqyrë e të ardhurave e planifikuar që tregon shumën dhe strukturën e pritur të kompanisë për periudhën e vëzhguar.

TË HYRAT – TË DALURAT = REZULTATI FINANCIAR

TË HYRAT > TË DALURAT = FITIM

TË DALURAT > TË HYRAT = HUMBJE

2.2. Analiza vertikale

Analiza vertikale është një mjet kontabël që mundëson analizën proporcionale të dokumenteve, siç janë pasqyrat financiare. Gjatë kryerjes së një analize vertikale, çdo zë në një pasqyrë

⁸ IASB. (2011, Februar 18). IAS 1: Presentation of Financial Statements. Retrieved Avgust 26, 2013, from IASB: <http://www.ifrs.org/Pages/default.aspx>

⁹ Saxena, V. (2016) Emerging importance of financial statement analysis. Volume 2; Issue 2; Page No. 01-05 pp 2-5 International Journal of Commerce and Management Research.

financiare futet si përqindje e një zëri tjetër. Për shembull, në një pasqyrë të të ardhurave, çdo zë tregohet në terma të përqindjes së shitjeve bruto¹⁰.

Në mënyrë të ngjashme, në një bilanc, çdo hyrje nuk bëhet në terma të monedhës absolute, por si përqindje e totalit të aktiveve. Kryerja e një analize vertikale të pasqyrës së fluksit monetar të një kompanie përfaqëson çdo dalje ose hyrje monetare në raport me flukset totale të parasë hyrëse.

Analiza vertikale përdoret më së shpeshti brenda një pasqyre financiare për një periudhë të vetme raportimi, p.sh., tremujore. Bëhet në mënyrë që kontabilistët të mund të konstatojnë përmasat relative të gjendjeve të secilës llogari. Analiza vertikale është jashtëzakonisht e dobishme gjatë hartimit të një analize regresioni ose një analize të trendit të raportit. Ai i mundëson kontabilistit të shohë ndryshimet relative në llogaritë e kompanisë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Analiza është veçanërisht e përshtatshme për ta bërë këtë në një bazë krahasuese.

Përparësitë e analizës vertikale janë¹¹:

- Analiza vertikale thjeshton korrelacionin midis zërave të vetëm në bilanc dhe rezultatit, pasi ato shprehen në përqindje. Menaxhmenti i një kompanie mund të përdorë përqindjet për të vendosur qëllimet dhe kufijtë e pragut. Për shembull, menaxhmenti mund të konsiderojë mbylljen e një njësie të caktuar nëse fitimi për njësi bie nën një përqindje të caktuar pragu.
- Është një mjet relativisht më i fuqishëm se analiza horizontale, e cila tregon ndryshimet përkatëse në financat e një njësie/llogarie/departamenti të caktuar për një periudhë të caktuar kohore.
- Është gjithashtu i dobishëm në krahasimin e pasqyrave financiare të një kompanie me tendencat mesatare në industri. Do të ishte joefektive të përdoren shumat aktuale të dollarit gjatë analizimit të industrive të tëra. Përqindjet me madhësi të përbashkët zgjidhin një problem të tillë dhe lehtësojnë krahasimin e industrisë.
- Është gjithashtu shumë efektiv kur krahasohen dy ose më shumë kompani që operojnë në të njëjtën industri, por me madhësi të ndryshme. Shpesh është e ndërlikuar të krahasosh bilancin e një kompanie prej 1 miliard dollarësh me një që vlerësohet në 500,000 dollarë.

¹⁰ Accounting for Management, n.d. Vertical (common-size) analysis of financial statements. [Online] Available at: <https://www.accountingformanagement.org/vertical-analysis-of-financial-statements/>

¹¹ <https://corporatefinanceinstitute.com/resources/knowledge/accounting/vertical-analysis/>

Analiza vertikale u mundëson kontabilistëve të krijojnë masa të përmasave të përbashkëta, të cilat u mundësojnë atyre të krahasojnë dhe krahasojnë sasitë e madhësive të ndryshme në një mënyrë shumë efikase.

2.3. Analiza horizontale

Analiza horizontale është një qasje e përdorur për të analizuar pasqyrat financiare duke krahasuar informacionin financiar specifik për një periudhë të caktuar kontabël me informacionin nga periudha të tjera. Analistët përdorin një qasje të tillë për të analizuar tendencat historike.

Tendencat ose ndryshimet maten duke krahasuar vlerat e vitit aktual me ato të vitit bazë. Qëllimi është të përcaktohet çdo rritje ose rënie në vlera specifike. Një përqindje ose një krahasim absolut mund të përdoret në analizën horizontale.

Analiza horizontale mund të krahasohet edhe me analizën vertikale. Ndërsa analiza vertikale analizon një pasqyrë të veçantë financiare duke përdorur vetëm një pasqyrë financiare bazë të periudhës raportuese, analiza horizontale krahason një pasqyrë financiare specifike me periudha të tjera ose analizën ndërseksionale të një kompanie kundrejt një kompanie tjetër.

Nga ana tjetër, kufizimi i krahasueshmërisë dikton që pasqyrat financiare të një kompanie dhe dokumentacioni tjetër të jenë të tillë që ato të mund të vlerësohen kundrejt kompanive të tjera të ngjashme brenda së njëjtës industri. Analiza horizontale përdoret për të përmirësuar dhe përmirësuar këto kufizime gjatë raportimit financiar.

Vlera e analizës horizontale u mundëson analistëve të vlerësojnë performancën e kaluar të kompanisë dhe pozicionin ose rritjen aktuale financiare dhe të projektojnë njohuritë e dobishme të fituara në të ardhmen. Megjithatë, kur përdoret teknika e analizës, periudha e krahasimit (aktuale) mund të duket jashtëzakonisht e keqe ose e mirë. Varet nga zgjedhja e vitit bazë dhe periudhave kontabël të zgjedhura në të cilat fillon analiza.

Në analizën horizontale, ndryshimet në vlerat specifike të pasqyrave financiare shprehen në përqindje dhe në vlera absolute. Për të llogaritur ndryshimin në përqindje, fillimisht zgjidhet viti bazë dhe viti i krahasimit. Më pas, llogaritet ndryshimi i vlerës absolutet duke zbritur vlerën në vitin bazë nga ajo në vitin e krahasimit dhe pjesëtoni me vitin bazë. Pas kësaj, rezultati shumëzohet me 100.

2.4. Treguesit financiar

Treguesit financiar janë mjeti kryesor për analizën financiare. Treguesit mund të standardizojnë informacionin financiar që mund të përdoret si një mjet krahasimi midis kompanive me madhësi të ndryshme¹²

Analiza e treguesve është raporti që përshkruan një vijë ndarëse ose një sasi tjetër krahasimi duke përdorur analizën e treguesit në formën e një grupi që mund t'i shpjegojë ose përshkruajë analistit për të mirën dhe të keqen pozicionin financiar të një kompanie.

Në literaturë dhe praktikë përdoren një numër i madh numrash treguesish, të cilët klasifikohen dhe grupohen në mënyra të ndryshme dhe sipas kritereve të ndryshme. Më shpesh, metoda e ndërtimit të tyre dhe karakteristikat e tyre të përgjithshme përdoren si kritere klasifikimi. Sipas mënyrës së ndërtimit treguesit ndahen në: tregues t; mbulueshmërisë, bartjes qarkullimit dhe pjesmarrjes relative¹³. Për lëndën tonë të analizës, klasifikimi nga pikëpamja e karakteristikave të tyre të përgjithshme është më i rëndësishëm dhe është si më poshtë:

- Treguesit e likuiditetit
- Treguesit e levës financiare
- Treguesit e aktivitetit ekonomik
- Treguesit e profitabilitetit

2.4.1. Treguesit e likuiditetit

Likuiditeti është një kusht për drejtimin financiar dhe një kusht i mbijetesës së ndërmarrjes. Menaxhmenti i ndërmarrjes duhet të ketë kujdes që të mbajë një lloj ekuilibri ndërmjet kohëzgjatjes së një operacioni për t'u financuar dhe kohëzgjatjes së mjeteve korresponduese të financimit.

Treguesit e likuiditetit kanë për qëllim të tregojnë aftësinë e ndërmarrjes për pagesën e obligimeve afatshkurta në afatin e caktuar, duke ruajtur shumën dhe strukturën e mjeteve xhiruese dhe bonitetin kreditor të vet ndërmarrjes. Te treguesit e likuiditetit, duhet vënë në dukje nevojën që krahas tregimit të likuiditetit rrjedhës dhe likuiditetit momental të përmendet edhe

¹² Keown, J. Arthur, John D. Martin, J. William Petty, and David F. Scott, Jr, 2001, Financial Management Principles and Applications, Prentice Hall, New Jersey

¹³ Ross, Stephen A., Randolph W. Westerfield, and Jeffrey F. Jaffe, 1993, Corporate Finance Third Edition, Richard D. Irwin Inc, America.

shuma neto e kapitalit qarkullues të firmës, si dhe diferenca ndërmjet mjeteve të përgjithshme qarkulluese të firmës dhe obligimeve të përgjithshme afatshkurta¹⁴.

Raportet e likuiditetit krahasojnë obligimet afatshkurta me burimet afatshkurtra apo të tanishme në dispozicion për të përmbushur detyrimet afatshkurtra. Raportet më të zakonshme të likuiditetit janë:

1. Koeficienti rrjedhës i likuiditetit,
2. Koeficienti i përshpejtuar i likuiditetit,
3. Koeficienti i likuiditetit aktuale
4. Koeficienti i stabilitetit financiar¹⁵

Koeficienti rrjedhës i likuiditeti

Koeficienti rrjedhës i likuiditetit (eng. current ratio) është tregues i likuiditetit i shkallës më të lartë, sepse venë në raport mbulesën dhe nevojat për kapital në një afat prej një viti.

$$Likuiditeti\ rrjedhës = \frac{\text{Mjetet qarkulluese}}{\text{Obligimet qarkulluese}}$$

Ky indikator mat aftësinë e kompanisë për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra. Vlera e llogaritur e këtij treguesit behet duke krahasuar me treguesit e tjerë të ndërmarrjeve në të njëjtën degë të industrisë. Vlera më e ulët e raportit kundrejt mesatares së industrisë tregon problemet e mundshme në aspektin e likuiditetit të ndërmarrjes. Besohet se koeficienti rrjedhës i Likuiditeti nëse është më pak se 1,5 nënkupton mundësinë që kompania të mbetet pa mjete për shlyerjen e detyrimet aktuale. Treguesi (koeficienti) vlera e të cilit është dukshëm më e lartë se mesatarja në industri mund të thotë se kompania nuk është duke përdorur burimet e veta në mënyrë efektive. Vlera të kënaqshme të raportit aktual është se ajo nuk do të devijojnë rëndësishëm se mesatarja e industrisë, dhe në qoftë se mesatarja industriale nuk është i njohur, atëherë ky raport duhet të jetë përafërsisht 2:1¹⁶.

¹⁴ Amihud, Yakov, and Haim Mendelson. 1986. "Liquidity and Stock Returns." Financial Analysts Journal. Vol. 42, No. 3: 43–48.

¹⁵ Halit Xhafa. Analiza e Pasqyrave Financiare, Tiranë, 2010

Koeficienti i përshpejtuar i likuiditetit

Koeficienti i likuiditetit të shpejtë (eng. quick ratio) është një masë e veçante e likuiditetit të shkalles së dytë, dhe është llogaritur duke përdorur formulën:

$$\text{Likuiditeti i përshpejtuar} = \frac{\text{Mjetet qarkulluese} - \text{rezervat}}{\text{Obligimet qarkulluese}}$$

Ky tregues tregon se kompania ka mjete të mjaftueshme afatshkurtra për përmbushjen e detyrimit të tij, pa shitjen e rezervave. Si tek koeficientin rrjedhës i likuiditetit, vlera e preferuar e këtij treguesi është se ajo nuk do të devijojnë shumë nga mesatarja e industrisë. Nëse mesatarja e industrisë nuk është e njohur, është e dëshirueshme koeficienti i përshpejtuar i likuiditetit të jete përafërsisht i barabartë me raportin e 1:1. Vlera e preferuar minimale e këtij raporti është 0.9.

Koeficienti i likuiditetit momental (cash ratio)

Koeficienti i likuiditetit momental është një matje e likuiditetit të një kompanie. Ai llogarit në mënyrë specifike raportin e parave totale të një kompanie dhe ekuivalentët e saj me detyrimet e saj aktuale. Metrika vlerëson aftësinë e kompanisë për të shlyer borxhin e saj afatshkurtër me para të gatshme ose burime pothuajse të gatshme, të tilla si letrat me vlerë lehtësisht të tregtueshme. Ky informacion është i dobishëm për kreditorët kur ata vendosin se sa para, nëse ka, do të ishin të gatshëm të huazonin një kompani¹⁷.

$$\text{Koeficienti i likuiditetit momental} = \frac{\text{Paraja}}{\text{Obligimet qarkulluese}}$$

Raporti i parësë së gatshme përdoret më së shpeshti si një masë e likuiditetit të një kompanie. Nëse kompania detyrohet të paguajë menjëherë të gjitha detyrimet aktuale, kjo metrikë tregon aftësinë e kompanisë për ta bërë këtë pa pasur nevojë të shesë ose likuidojë aktive të tjera. Një raport i parave shprehet si një numër, më i madh ose më i vogël se 1. Me llogaritjen e raportit, nëse rezultati është i barabartë me 1, kompania ka saktësisht të njëjtën sasi të detyrimeve aktuale si ajo ka para dhe ekuivalentet e saj për të shlyer këto borxhe.

¹⁷ <https://www.investopedia.com/terms/c/cash-ratio.asp>

Nëse raporti i mjeteve monetare të një kompanie është më i vogël se 1, ka më shumë detyrime aktuale sesa paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj. Nëse raporti i mjeteve monetare të një kompanie është më i madh se 1, kompania ka më shumë para dhe ekuivalente monetare sesa detyrimet aktuale. Në këtë situatë, kompania ka aftësinë të mbulojë të gjithë borxhin afatshkurtër dhe të ketë ende para të gatshme.

2.4.2. Treguesit e levës financiare

Raportet e levës janë çdo lloj raporti financiar që tregon nivelin e borxhit të krijuar nga një njësi ekonomike kundrejt disa llogarive të tjera në bilancin e tij, pasqyrën e të ardhurave ose pasqyrën e fluksit monetar. Këto raporte ofrojnë një tregues se si financohen aktivet dhe operacionet e biznesit të kompanisë (duke përdorur borxhin ose kapitalin).

Raportet e levës përfaqësojnë masën në të cilën një biznes po përdor paratë e huazuara. Ai gjithashtu vlerëson aftësinë paguese të kompanisë dhe strukturën e kapitalit. Të kesh levë të lartë në strukturën e kapitalit të një firme mund të jetë e rrezikshme, por gjithashtu ofron përfitime.

Përdorimi i levës është i dobishëm gjatë kohëve kur firma po fiton fitime, pasi ato përforcohen. Nga ana tjetër, një firmë me shumë levë do të ketë probleme nëse përjeton një rënie të përfitueshmërisë dhe mund të jetë në një rrezik më të lartë mospagimi sesa një firmë e palidhur ose me më pak levë në të njëjtën situatë.

Treguesit më të zakonshëm të borxhit janë:

- borxhi total (Debt Ratio);
- raporti borxh/kapital (Debt/Equity Ratio);
- tregues i mbulimit të interesit (Interest cover Ratio);

Koeficienti i obligimeve – debt ratio

Koeficienti i obligimeve përkufizohet si raport i borxhit total ndaj totalit të aktiveve, i shprehur si dhjetore ose përqindje. Mund të interpretohet si përqindja e aktiveve të një kompanie që financohen nga borxhi. Një raport më i madh se 1 tregon se një pjesë e konsiderueshme e borxhit të një kompanie financohet nga aktivet, që do të thotë se kompania ka më shumë detyrime sesa aktive. Një raport i lartë tregon se një kompani mund të jetë në rrezik të mospagimit të huave të saj nëse normat e interesit rriten papritur. Një raport nën 1 do të thotë që një pjesë më e madhe e

aktiveve të një kompanie financohet nga kapitali.¹⁸ Si rregull vlera e koeficientit të borxhit do të duhet të jetë 50% ose më pak¹⁹.

Formula që përcakton koeficientin e obligimeve është

$$\text{Koeficienti i obligimeve} = \frac{\text{Obligimet e përgjithshme}}{\text{Pasuria e përgjithshme}}$$

Raporti borxh/kapital (Debt/Equity Ratio);

Raporti borxh/kapital (D/E) është një tregues financiar që tregon raportin relativ të kapitalit aksioner dhe totalit të borxhit të përdorur për financimin e aktiveve (aseteve) të shoqërisë.

$$\text{Raporti borxh/kapital} = \frac{\text{Borxhi i përgjithshëm}}{\text{Kapitalin vetanak}}$$

Raporti borxh / kapitali vetanak është një nga treguesit kryesorë financiarë dhe përdoret si standard për vlerësimin e gjendjes financiare të kompanisë. Është gjithashtu një masë e aftësisë së kompanisë për të shlyer detyrimet e saj.

Kur shqyrtohet "shëndeti" i një kompanie, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje raportit borxh-kapital. Nëse vlera e këtij treguesi rritet, do të thotë se kompania financohet më shumë nga kreditorët sesa nga burimet e saj financiare, gjë që mund të jetë një tendencë e rrezikshme. Huadhënësit dhe investitorët zakonisht preferojnë një raport të ulët borxhi ndaj kapitalit, sepse interesat e tyre mbrohen më mirë në rast të performancës së dobët të një kompanie. Kështu, një kompani me një raport të lartë borxhi ndaj kapitalit nuk mund të tërheqë lehtësisht kapital shtesë. Nëse raporti i totalit të borxhit është 0.5, kjo do të thotë se gjysma e mjeteve në dispozicion financohen me borxh të jashtëm.

Niveli optimal i raportit borxh-kapital konsiderohet të jetë 1, domethënë, borxhi (detyrimet) duhet të jetë i barabartë me kapitalin. Megjithatë, duhet pasur parasysh se ky tregues është

18 Accounting Tools. "Debt ratios." <https://www.accountingtools.com/articles/debt-ratios.html> Accessed Nov. 2, 2021.

19 .Davidson N. Wallace, McDonald James, "Guide to financial Statement Analysis: Basis for Management Advice", American Institute of certified Public Accountants, 2006

specifik kur bëhet fjalë për aktivitete të ndryshme, sepse shuma e tij varet nga proporcioni i aktiveve korrente dhe afatgjata të shoqërisë specifike²⁰.

Treguesi i mbulimit të kamatës (Interest Cover Ratio)

Raporti i mbulimit të interesit përdoret për të përcaktuar aftësinë e një kompanie për të servisuar interesin për borxhin e papaguar. Raporti i mbulimit të interesit përfaqëson raportin ndërmjet të ardhurave të kompanisë para taksave dhe interesit (fitimi operativ dmth. EBIT²¹) dhe vlerës së detyrimeve të interesit.

$$\text{Treguesi i mbulimit të kamatës} = \frac{\text{Fitimioperativ}}{\text{Kamata}}$$

Sa më e ulët të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë kompania rëndohet me kosto në emër të interesit. Nëse raporti i mbulimit të interesit të një kompanie është 1.5 ose më pak, aftësia e saj për të mbuluar kostot e interesit mund të vihet në dyshim. Nëse treguesi është nën 1, tregon se kompania nuk gjeneron të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kostot e interesit. Një vlerë mbi 1.5 konsiderohet si vlerë pozitive e këtij treguesi.

Shpenzimet e kamatave ndikojnë në profitabilitetin e kompanisë. Analiza për shpenzimet dhe përfitimet duhet të tregojë se huamarrja e parave për financimin e kompanisë a ka efekt pozitiv apo jo. Raporti më i lartë i mbulimit të interesit do të jetë një tregues i kapacitetit të borxhit të kompanisë.

2.4.4. Treguesit e profitabilitetit

Treguesit e profitabilitetit matin aftësinë e një kompanie për të fituar një kthim adekuat mbi aktivet dhe kapitalin e vet. Këta tregues vlerësojnë në fakt aftësinë e biznesit për të gjeneruar të ardhura në krahasim me kostot e bëra gjatë operimit, pra aftësinë e kompanisë për të menaxhuar kostot e operacionit. Treguesit për marzhin e fitimit të arritur japin informacion se cilët faktorë kontribuojnë për realizimin e fitimit dhe më së shpeshti shprehen si pjesë e çdo denari të arritur²².

²⁰ Checkley Keith, "Strategic Cash Flow Management", John Wiley and Sons, 2002

²¹ Earnings before interest and taxes

²² Gadoiu, M. (2014) Advanages and limitations of the financial ratios used in the financial diagnosis of the enterprise. Scientific Bulletin – Economic Sciences, Volume 13/ Issue 2.

Për shumicën e treguesve të profitabilitetit, vlen rregulli - një vlerë më e lartë e këtij raporti në krahasim me raportin e kompanive konkurruese ose raportet e viteve të mëparshme do të thotë se biznesi po ecën mirë. Për llogaritjen e treguesve të analizës së përfitimit, përdoren informacionet kontabël të kompanisë të paraqitura në Bilancin e suksesit dhe shënimet sqaruese të cilat kanë të bëjnë me bilancin e suksesit.²³

Si tregues më të përgjithshëm janë:

1. Marzha e fitimit bruto
2. Marzha e fitimit operativ
3. Marzha e fitimit neto
4. Norma e kthimit nga aktivet (ROA)
5. Norma e kthimit nga kapitali (ROE)²⁴

Marzha e fitimit bruto

Marzha e fitimit bruto është një tregues financiar që tregon pjesën e çdo qindarke të shitjeve që mbetet pas zbritjes së kostove të prodhimit. Me fjalë të tjera, marzhi e fitimit bruto tregon pjesën e çdo qindarke të shitjes që është në dispozicion për të mbuluar kostot operative (kosto që nuk lidhen drejtpërdrejt me procesin e prodhimit: kostot fikse, kostot e pagave administrative, amortizimi i pasurive të paluajtshme, pajisjet në administrim etj.)

Marzhi i fitimit bruto llogaritet si raport midis diferencës midis të ardhurave nga shitjet dhe koston së mallrave të shitura nga njëra anë dhe të ardhurave totale nga shitjet nga ana tjetër:

$$\text{Marzha e fitimit bruto} = \frac{\text{Shitjet} - \text{Kosto e prodhimeve të shitura}}{\text{shitjet}}$$

Marzhi i fitimit bruto përdoret për të bërë një krahasim të shoqërisë së analizuar, si me periudhat e mëparshme, ashtu edhe me konkurrentët dhe mesataren e arritur të aktivitetit. Një marzh më i lartë i fitimit bruto mund të nënkuptojë një funksionim më fitimprurës të kompanisë, megjithatë, nëse arrihet përmes rritjes së çmimeve të shitjes, mund të vërë në pikëpyetje konkurrencën e kompanisë në treg, gjë që mund të çojë në një ulje të vëllimit të shitjeve. Nga ana tjetër, një marzh i

²³ Chan, Louis K.C., Narasimhan Jegadeesh, and Josef Lakonishok. 1999. "The Profitability of Momentum Strategies." *Financial Analysts Journal*. Vol. 55, No. 6: 80–90.

²⁴ Ibid

ulët fitimi bruto, nëse nuk ka një vëllim mjaftueshëm të madh shitjesh, mund të çojë në një situatë ku kompania nuk është në gjendje të mbulojë kostot e mbetura operative.

Marzha operative e fitimit

Marzhi i fitimit operativ si tregues financiar mat atë pjesë të të ardhurave të kompanisë që mbetet pas pagesës së kostove variable të prodhimit, si pagat, lëndët e para, etj.

Marzha e fitimit operativ

$$= \frac{\text{Shitjet} - \text{Kosto e prodhimeve të shitura} - \text{shpenzimet operative}}{\text{shitjet}}$$

Apo

$$\text{Marzha e fitimit operativ} = \frac{\text{Fitimi operativ}}{\text{shitjet}}$$

Në procesin e analizimit të profitabilitetit së një kompanie, është mirë të shikohen ndryshimet në marzhin e fitimit operativ gjatë viteve dhe të krahasohen të dhënat vjetore ose tremujore të kompanisë me ato të konkurrentëve të saj ose mesataren e industrisë. Nëse ky tregues regjistron një tendencë në rritje, kjo do të thotë se kompania fiton më shumë për çdo qindarkë të shitjeve. Për shembull, nëse kompania ka një marzh të fitimit operativ prej 15%, do të thotë se fiton 0,15 denarë (para kamatës dhe taksave) për çdo denarë të realizuar në shitje.

Marzha neto e fitimit

Marzhi i fitimit neto tregon fitimin neto të krijuar nga çdo qindarkë e shitjeve të bëra. Gjithashtu merr parasysh kostot financiare që marzhi i fitimit operativ nuk i përfshin në llogaritje. Ai paraqet raportin ndërmjet vlerës së fitimit neto të realizuar (fitimi pas zbritjes së taksave dhe interesit) dhe vlerës së shitjeve të realizuara.

$$\text{Marzha e fitimit neto} = \frac{\text{Neto fitimi}}{\text{shitjet}}$$

Marzhi i fitimit neto është një nga numrat më të ndjekur në financë. Aksionarët, si dhe investitorët e mundshëm, shikojnë nga afër dhe me kujdes marzhin e fitimit neto, sepse tregon se sa e suksesshme është kompania në konvertimin e të ardhurave në fitime të disponueshme për aksionerët.

Ndërsa kostot e një kompanie rriten, fitimet neto mund të bien. Edhe nëse kompania përpiqet të kompensojë kostot shtesë duke rritur çmimin e shitjes së produktit, kjo mund të rezultojë në një ulje të vëllimit të shitjeve, sepse konsumatorët mund të mos jenë të gatshëm ta blejnë produktin me një çmim më të lartë. Nëse kjo do të ndodhte, të ardhurat totale mund të zvogëloheshin pavarësisht rritjes së çmimit të produktit. Por në disa situata mund të ndodhë e kundërta, kostot ulen - prodhimi dhe shitjet rriten.

Normat e kthimit nga kapitali (ROE)

Norma e kthimit nga kapitali (ROE) është treguesi për të cilin investitorët janë më të interesuar. Çdo investitor dëshiron të dijë kthimin e kapitalit të investuar në kompani. Norma e kthimit nga kapitali llogaritet si raport ndërmjet fitimit neto dhe kapitalit mesatar.

$$\text{Norma e kthimit nga kapitali (ROE)} = \frac{\text{Neto fitimi}}{\text{kapitali akcionar}}$$

Norma e kthimit të aktiveve të biznesit (ROA)

Kompania investon në forma të ndryshme të aktiveve korrente dhe fikse me synimin për të realizuar përfitimet më të mëdha të mundshme në këto aktive të matura me norma të caktuara kthimi. Treguesi bazë i rendimentit ose përfitimit në aktivitetin e biznesit të kompanisë është shkalla e kthimit të aktiveve totale, e cila merret duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\text{Norma e kthimit nga aktivet (ROA)} = \frac{\text{Neto fitimi}}{\text{Aktiva mesatare}}$$

Kreu III – Analiza horizontale, vertikale dhe racio analiza në sektorinë e minierave në Maqedoninë e Veriut

3.1. Analiza horizontale e Bilancit të Gjendjes dhe Bilancit të Suksesit në sektorin e minierave (2020-2017) në mënyrë individuale dhe të përbashkët dhe interpretimi rezultateve

Nga rezultatet e arritura të shprehura në tabelat në këtë kapitull të punimit shkencor dhe poashtu rezultatet të interpretuara më poshtë, konstatohet që hipoteza e parë e parashtruar do të pranohet dhe gjithashtu vërtetohet që financimi i pasurisë nga burimet vetanake dhe nga obligime në kompanitë e analizuara është mjaftë asimetrike përgjatë periudhës 2020-2017.

Analiza dhe interpretimi i pasqyrave financiare janë një përpjekje për të përcaktuar rëndësinë dhe kuptimin e të dhënave të pasqyrave financiare në mënyrë që të mund të bëhet një parashikim i perspektivës për të ardhurat e ardhshme, aftësinë për të paguar interesin, maturimet e obligimet, si ato aktuale ashtu edhe ato afatgjata. dhe përfitueshmëria e politikës së shëndoshë të dividendit.

Analiza e pasqyrave financiare vlerëson performancën ose vlerën e një kompanie përmes bilancit të një kompanie, pasqyrës së të ardhurave ose pasqyrës së flukseve monetare. Duke përdorur një sërë teknikash të tilla si analiza horizontale, vertikale ose raporti, investitorët mund të zhvillojnë një pamje më të nuancuar të profilit financiar të një kompanie.

Analiza horizontale quhet edhe si Analiza Dinamike. Nën këtë lloj analize, rishikohet ose analizohet krahasimi i trendit të secilit zë në pasqyrat financiare për numrin e viteve. Ky lloj krahasimi ndihmon për të identifikuar tendencën në tregues të ndryshëm të performancës. Në këtë lloj analize, shifrat e vitit aktual krahasohen me vitin bazë, sepse shifrat janë paraqitur horizontalisht mbi një numër kolonash

Kjo analizë bëhet duke analizuar deklaratat për një periudhë kohore. Sipas kësaj analize, ne përpiqemi të shqyrtojmë se cila ka qenë tendenca periodike e zërave të ndryshëm të paraqitur në raport. Analiza horizontale konsiston në një studim të sjelljes së secilit prej entiteteve në raport.

Me ndihmën e Excell duke i dhënë formulat për gjetjen e analizës horizontale arrijmë në rezultate më të shpejta. **Formulat e përdorura në këtë analizë janë:**

Ndryshimi në denar= vlera e vitit aktual – vlera e vitit bazë

Tabela 1. Tabela e përbashkët e analizës horizontale të Bilancit të Gjendjes

Pozicioni - B.Gj	2018 / 2017			2019 / 2018			2020 / 2019			2020/2017		
Kompanitë	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)
Aktivitet afatgjatë	398148	-4.87		5.96	72.1	12	-4.64	-10	0.28	402301	47	
Aktivitet Afatshkurta	4314	-54.2	898	-68.8	68.8	-18.8	2611	38.4	-42.5	37200	7	365.6
Totali Aktiveve	123392	-36.8	6433	4.1	70.6	7.2	14.8	12.1	-4.66	147590	21	6582.6
Kapital	1241.1	83.3	963	-420.	57.7	-0.98	-14.21	-16	-28.3	-3794	141	654.3
Obligimet	552114	-59.9		7.72	81.9	8.89	14.15	34.2	-0.47	678917	-2	
Totali	12339	-36.8	6433	4.10	70.6	7.28	14.89	12.1	-4.66	147590	21	6582.2

Burimi: Analiza vetanake të autorit

Në tabelat më poshtë do të paraqiten analizat horizontale për kompanitë dhe interpretimi rezultateve.

Me anë të analizës horizontale të pasqyrës së të ardhurave arrijmë të shohim ecurinë financiare të ndërmarrjes nga viti në vit.

Tabela 2. Tabela e përbashkët e analizës horizontale të Bilancit të Gjendjes

Pozicioni - B.S	2018 / 2017			2019 / 2018			2020 / 2019			2020/2018		
Kompani të	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)	Volostone (%)	Fimar (%)	Almarco (%)
Të ardhurat totale operative	50621	-25		-90.5	23.6		19206	2.47		1728	27	
Totali i shpenzimeve operative	213759	-28		348.7	25.4	-17	396.4	19.9	1385	2128	51	1129
Fitimi operativ	12603	-3.8		-1814	12.3	-17.2	-115.16	-121	1385	160	-124	1129
Fitimi neto	11050.3	-1.4		-2133	14.1	-18.7	-110.82	-122	1384	120	-126	1107

Në tabelat e paraqitura më poshtë do të shohim rezultatet e nxjerra nga analizat horizontale të kompanive dhe interpretimin e rezultateve.

3.1.1. Analiza horizontale e Volostone për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit

3.1.1.1. Analza horizontale e ndërmarrjes Voloston për Bilancin e Gjendjes

Nga rezultatet e nxjerra duke marrë parasysh elementet kyçe që e përbëjnë bilancin e gjendjes duke filluar nga mjetet mund të konkludojmë që aktivet afatgjate në fillim kanë pasur vlerën **122,420 denarë** dhe më pas rritja më e madhe e aktiveve afatgjate/mjeteve themelore sipas tabelës shohim që është në vitin 2018 për dallim nga viti bazë në vitin 2018 ka vlerën **488,608,224 denarë**, në vitet tjera vijuese fillojnë të ulen aktivet afatgjate.

Elementi tjetër që përfshin aktiven e bilancit të gjendjes janë aktivet afatshkurte/mjetet qarkulluese në vitin bazë kanë pasur vlerën 283,162 denar në vitet vijuese vazhdon rritjen dhe rritja më e madhe e aktiveve afatshkurte ka ndodhur në vitin 2020 me vlerën prej **101,725,646 denarë**.

Në total të aktives vërejm se aktiva më e lartë është në vitin 2018 gjithsej 500,826,526, më pas shënon ulje në vitin 2018 dhe sërish rritje në vitin 2020 si rezultat i arkëtimeve, shpenzimeve të parapaguara, cash-it.

Tabela 3. Balance të Gjendjes të ndërmarrjes Volostone për vitet 2017 - 2020

Pozicioni	2017 / 2016		2018 / 2017		2019 / 2018		2020 / 2019		2020/2017	
AKTIVET	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	Në %
Aktivitet AFATGJAT A	122		488,608	398148.81	29,150	5.96	-24,054	-4.64	493,703	402301
Aktivitet afatshkurte	283		12,218	4314.95	-8,606	-68.85	101,725	2611.97	105,337	37200
Totali aktiveve	405		500,826	123392.15	20,543	4.10	77,670	14.89	599,040	147590
Kapitali	315		3,923	1242.16	-17,841	-420.82	1,932	-14.21	-11,984	-3794
Obligimet	90		496,902	552114.20	38,384	7.72	75,738,	14.15	611,025	678917
Obligimet afatshkurte	90		31,940	35489.80	20,886	65.21	75,266	142.23	128,093	142326
Obligimet afatgjata	0		464,961		17,497	3.76	472	0.10	482,931	
Totali i kapitalit dhe rezervat	405		500,826	123392.15	20,543	4.10	77,670	14.89	599,040	147590

Burimi: Balance të Gjendjes të Volsotone (2017-2020) dhe përllogaritje të autorit

Në total të aktives vërejm se aktiva më e lartë është në vitin 2018 gjithsej 500,826,526, më pas shënon ulje në vitin 2018 dhe sërish rritje në vitin 2020 si rezultat i arkëtimeve, shpenzimeve të parapaguara, cash-it.

Në pjesën tjetër të bilancit/burimet e mjeteve, na tregojnë se me se janë financuar aktivet, sa prej tyre me burime vetanake e sa me burime të huaja financiare. Nga rezultatet e nxjerra nga vitit në vit arrijmë të shohim ecurinë e pasives së bilancit të gjendjes ku Kapitali si burim vetanak ndryshon nga viti bazë që ka qenë 315,882 në rritje prej 3,923,747 denar në vitin 2018 më pas ulet për -17,841,132 denar në vitin 2019 ndërsa më pas shënon sërish rritje të vlerës prej 1,923,865 denar si rezultat i fitimit të mbajtur/të pashpërndarë, i rezervave.

Obligimet/obligimet si burime të huaja të financimit të mjeteve/aktives e përbëjnë obligimet afatshkurte që ka shënuar rritje duke krahasuar nga viti bazë tek viti 2020 si rezultat i obligimeve

tregtare, huamarrjeve afatshkurte, shpenzimet e përlllogaritura, ndërsa obligimet afatgjate janë rritur më shumë në vitin 2018 dhe më pas kanë shënuar ulje kjo si rezultat i huamarrjeve afatgjate.

3.1.1.2. Analza horizontale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Suksestit

Me anë të analizës horizontale të pasqyrës së të ardhurave arrijmë të shohim ecurinë financiare të ndërmarrjes nga viti në vit

Tabela 4. Balance të Suksestit të ndërmarrjes Volostone për vitet 2017 - 2020

Pozicionet	2017 vs 2016		2018 vs 2017		2019 vs 2018		2020 vs 2019		2020/2018	
	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	Në %
Të ardhurat totale operative	10		5,062	50621.5	-4,591	-90.53	92,243	19206.2	87,651,8	1728
Totali i shpenzimeve operative	2		4,040	213759.2	14,096	348.76	71,908	396.43	86,004,7	2128
Fitimi operativ	8		1,022	12603.01	-18,688	-1814	20,335	-115.16	1,647,09	160
Të ardhurat totale financiare	17		2	12841.18	22	986.23	-23	-98.98	-2	-89
Totali i Shpenzimeve Financiare	245		102	41859.18	134	130.18	293	123.95	427	415
Fitimi neto	7		871	11050.34	-18,750	-2133.4	19,804	-110.82	1,053	120
TOTAL TË ARDHURA GJITHËPËRFSH IRËSE	8		871	11050.34	-18,750	-2133.4	19,804	-110.82	1,053	120

Burimi: Balance të Suksestit të Volsotone (2017-2020) dhe përlllogaritje të autorit

Për kompaninë Volostone në periudhën 2016-2020 shohim që të ardhurat në dy vitet e para të analizës kanë qenë kryesisht të ulëta në krahasim me vitin 2018 që ka rritje të të ardhurave totale operative me nga 10.000 denar për 5,062,152 denarë ndërsa karakterizohet me ulje të të ardhurave në vlerë të madhe në vitin 2019 me 4,591,873 den ulje ndërsa në vitin 2020 sërish kryeson me rritje të të ardhurave totale me vlerë prej 92,243,741 denar.

3.1.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Fimar

3.1.2.1. Analiza horizontale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Gjendjes

Nga rezultatet e nxjerra duke marrë parasysh elementet kyçe që e përbëjnë bilancin e gjendjes duke filluar nga mjetet mund të konkludojmë që aktivet afatgjate në fillim kanë pasur vlerën **92,438,127 denarë** dhe më pas rritja më e madhe e aktiveve afatgjate/mjeteve themelore sipas tabelës shohim që është në vitin 2019 me 108,353,159 për dallim nga viti bazë dhe nga ulja që ka në vitin 2018.

Tabela 5. Balance të Gjendjes të ndërmarrjes Fimar për vitet 2017 – 2020

Pozicio ni	2017 / 2016		2018 / 2017		2019 / 2018		2020 / 2019		2020/2017	
AKTIVET	në denarë (000)	n ë %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në%	në denarë (000)	Në %
Aktivet AFATGJJA TA	92,438		-7,678	-4.87	108,353	72.19	-27,241	-10.54	73,432	47
Aktivet afatshku rte	232,126		-157,147	-54.21	91,402	68.86	86,078	38.40	20,333	7
Totali aktiveve	324,564		-164,826	-36.82	199,755	70.63	58,837	12.19	93,766	21
Kapitali	68,029		60,214	83.37	76,496	57.76	-34,935	-16.72	101,774	141
Obligime t	256,535		-225,040	-59.94	123,259	81.96	93,772	34.27	-8,008	-2
Totali i kapitalit dhe rezervat	324,564		-164,826	-36.82	199,755	70.63	58,837	12.19	93,766	21

Burimi: Balance të Gjendjes të Fimar (2017-2020) dhe përlogaritje të autorit

Elementi tjetër që përfshin aktiven e bilancit të gjendjes janë aktivet afatshkurte/mjetet qarkulluese në vitin bazë kanë pasur vlerën maksimale me 232,126,828 denar më pas në vitet vijuese vazhdon uljen me diferenc -157,147,917 den. Dhe sërish dallim pozitiv/rritje në vitet 2018, 2019 .

Në total të aktives vërejm se aktiva më e lartë është në vitin 2017 gjithsej 324,564,955 denar më pas shënon ulje në vitin 2018 dhe sërish rritje në vitin 2019 dhe 2020 si rezultat i arkëtimeve, shpenzimeve të parapaguara, cash-it, investimeve financiare afatshkurta, arkëtimet tregtare, inventarët.

Në pjesën tjetër të bilancit/burimet e mjeteve, na tregojnë se me se janë financuar aktivet, sa prej tyre me burime vetanake e sa me burime të huaja financiare. Nga rezultatet e nxjerra nga vitit në vit arrijmë të shohim ecurinë e pasives së bilancit të gjendjes ku Kapitali si burim vetanak nga viti bazë dhe 2017 ka vlera më të larta se në vitin 2018 prej 68,029,296 denar. në vitin 2018 më pas ulet për 60,214,287 denar, ndërsa në vitin 2019 shënon rritje më të lartë të vlerës prej 76,496,081 denarë si rezultat i fitimit të mbajtur/të pashpërndarë, i rezervave.

Obligimet/obligimet si burime të huaja të financimit të mjeteve/aktives e përbëjnë obligimet afatshkurte që ka shënuar rritje duke krahasuar nga viti bazë tek viti 2020 si rezultat i obligimeve tregtare, huamarrjeve afatshkurte, shpenzimet e përlllogaritura, ndërsa obligimet afatgjate janë rritur më shumë në vitin 2017 dhe më pas kanë shënuar ulje kjo si rezultat i obligimeve afatshkurte, obligimeve tatimore të prolonguara.

3.1.2.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Suksesit

Për kompanin Fimar në periudhën 2016-2020 shohim që të ardhurat totale operative në dy vitet e para të analizës 2016-2017 ka vlerën maksimale 637,247,293 më pas në vitet tjera në vazhdim ka ulje pastaj rritje me dallim për 127,481,694 den në 2019 dhe sërish rritje me dallim për 16,470,700 denar në 2020.

Tabela 6. Balance të Suksesit të ndërmarrjes Volostone për vitet 2017 - 2020

Pozicioni	2017 vs 2016		2018 vs 2017		2019 vs 2018		2020 vs 2019		2020/2018	
	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	Në %
Të ardhurat totale operative	637,247		-187,099	-25.78	127,481	23.67	16,470	2.47	143,952	27
Të ardhurat nga shitjet	632,972		-185,209	-25.68	129,83	24.22	15,909	2.39	145,741	27
Totali i shpenzimeve operative	567,388		-184,172	-28.37	118,417	25.46	116,657	19.99	235,074	51
Shpenzime të tjera operative	-411		897	212.33	-1,222	-92.62	993	1019.70	-228	-17
Fitimi operativ	69,859		-2,926	-3.83	9,064	12.34	-100,186	-121.43	-91,122	-124
Të ardhurat totale financiare	671		-551	-78.02	627	404.06	3,546	453.13	4,173	2688
Totali i Shpenzimeve Financiare	-1,869		-749	-43.99	1,364	143.03	1,794	77.39	3,159	331
Fitimi neto	65,374		-1,012	-1.49	9,478	14.14	-93,962	-122	-84,483	-126
TOTAL TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE	65,374		-1,012	-1.49	9,478	14.14	-93,962	-122	-84,483	-126

Burimi: Balance te Suksesit të Ndërmarrjes Fimar dhe përlogaritje të autorit

Shpenzimet totale financiare kanë shënuar ulje në vitin 2018 përdallim prej vitit paraprak, më pas në dy vitet vijuese ka dallim pozitiv dmth rritje të tyre si dhe nëse e analizojmë kolonën e fundit në aspekt horizontal përgjatë viteve të ardhurat totale gjithëpërfshirëse vërejmë dallim negativ për -1,012,080 den në vitin 2018-2017 më pas në vitin vijues dallime pozitive dmth për 14.14% për 2019-2018 dhe sërish ulje apo dallim negativ përgjatë krahasimit 2020-2019 me -122.83%

3.1.3. Analiza horizontale e ndërmarrjes Almarco

3.1.3.1. Analza horizontale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes

Nga rezultatet e nxjerra duke marrë parasysh elementet kyçe që e përbëjnë bilancin e gjendjes duke filluar nga mjetet mund të konkludojmë që aktivet afatgjate në fillim kanë pasur vlerën **122,420 denar** dhe më pas rritja më e madhe e aktiveve afatgjate/mjeteve themelore sipas tabelës shohim që është në vitin 2018 për dallim nga viti bazë në vitin 2018 ka vlerën **488,608,224 denar**, në vitet tjera vijuese fillojnë të ulen aktivet afatgjate.

Tabela 7. Balance të Gjendjes të ndërmarrjes Almarco për vitet 2017 – 2020

Pozicioni	2017 vs 2016		2018 vs 2017		2019 vs 2018		2020 vs 2019		2020 vs 2017	
AKTIVET	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në %	në denarë (000)	në%	në denarë (000)	Në %
Aktivitet AFATGJATA	0		17,048		2,045	12.00	53	0.28	19,147	
Aktivitet afatshkurte	308		2,766	898.12	-579	-18.86	-1,060	-42.50	1,126	365
Totali aktiveve	308		19,814	6433.19	1,465	7.28	-1,006	-4.66	20,273	6582
Kapitali dhe obligimet									0	
Kapitali	308		2,968	963.81	-32	-0.98	-921	-28.39	2,015	654
Obligimet	0		16,845		1,497	8.89	-85	-0.47	18,257	
Obligimet afatshkurte	0		16,845		1,497	8.89	-85,	-0.47	18,257	
Totali i kapitalit dhe rezervat	308		19,814	6433.19	1,465	7.28	-1,006,	-4.66	20,273	6582

Elementi tjetër që përfshin aktiven e bilancit të gjendjes janë aktivet afatshkurte/mjetet qarkulluese në vitin bazë kanë pasur vlerën 283,162 denar në vitet vijuese vazhdon rritjen dhe rritja më e madhe e aktiveve afatshkurte ka ndodhur në vitin 2020 me vlerën prej **101,725,646 denarë**.

Në total të aktives vërejm se aktiva më e lartë është në vitin 2018 gjithsej 500,826,526, më pas shënon ulje në vitin 2018 dhe sërish rritje në vitin 2020 si rezultat i arkëtimeve, shpenzimeve të parapaguara, cash-it.

Në pjesën tjetër të bilancit/burimet e mjeteve, na tregojnë se me se janë financuar aktivet, sa prej tyre me burime vetanake e sa me burime të huaja financiare. Nga rezultatet e nxjerra nga vitit në vit arrijmë të shohim ecurinë e pasives së bilancit të gjendjes ku Kapitali si burim vetanak ndryshon nga viti bazë që ka qenë 315,882 në rritje prej 3,923,747 denar në vitin 2018 më pas ulet për -17,841,132 denar në vitin 2019 ndërsa më pas shënon sërish rritje të vlerës prej 1,923,865 denar si rezultat i fitimit të mbajtur/të pashpërndarë, i rezervave.

Obligimet/obligimet si burime të huaja të financimit të mjeteve/aktives e përbëjnë obligimet afatshkurte që ka shënuar rritje duke krahasuar nga viti bazë tek viti 2020 si rezultat i obligimeve tregtare, huamarrjeve afatshkurte, shpenzimet e përlllogaritura, ndërsa obligimet afatgjate janë rritur më shumë në vitin 2018 dhe më pas kanë shënuar ulje kjo si rezultat i huamarrjeve afatgjate.

3.1.3.2. Analiza horizontale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes

Sipas të dhënave të nxjerra me anë të formulës për analizë horizontale, në rezultatet e shprehura në tabelën më poshtë mund të konkludojmë që pasqyra e të ardhurave për kompanin Almarco ndër vite ka operuar me të ardhura totale operative 0 ndërvite.

Tabela 8. Bilance të Suksesit të ndërmarrjes Almarco për vitet 2017 – 2020

Pozicionet	2017 vs 2016		2018 vs 2017		2019 vs 2018		2020 vs 2019		2020 vs 2018	
	në denarë (000)	%	në denarë (000)	%	në denarë (000)	%	në denarë (000)	%	në denarë (000)	%
Të ardhurat totale operative	0		0		0		0		0	
Totali i shpenzimeve operative	0		75		-12	-17.24	859	1385.38	846	1129
Fitimi operativ	0		-75		12	-17.24	-859	1385.38	-846	1129
Të ardhurat totale financiare	0		0		0		0		0	
Totali i Shpenzimeve Financiare	0		1.4		-1,4	-100			-1.4	-100
Fitimi neto	0		-76		14	-18.73	-859	1384.96	-844	1107
TOTAL TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE	0		-76		14	-18.73	-859	1384.96	-844	1107

Burimi: Bilancet e Suksesit të ndërmarrjes Almarco dhe përlogaritje të autorit

Ndërsa Shpenzimet totale operative nga viti bazë deri tek viti 2018 ka shënuar ndryshim pozitiv me vlerën prej 74,958 denar, ndërsa në krahasim me këtë vit në vitin 2019 kemi ulje të shpenzimeve operative për 17.24% ndërsa në krahasim me këtë vit, viti 2020 shënon rritje të shpenzimeve operative, ndryshim pozitiv me vlerë prej 859,447 denar.

Nëse analizojmë totalin e të ardhurave gjithëpërfshirës në vitet krahasuese 2018-2017 ka ndryshim negativ, më pas në vitet krahasuese 2019-2018 shohim që ka ndryshim për 14,298 denar, ndërsa 2020-2019 ndryshimi negativ apo ulja e të ardhurave gjithëpërfshirëse është për vlerën 859,188 denarë.

3.2. Analiza vertikale e Bilancit të Gjendjes dhe Bilancit të Suksesit në sektorin e minierave (2020-2017) në mënyrë individuale dhe të përbashkët dhe interpretimi rezultateve

Analiza vertikale është një teknikë financiare nëpërmjet të cilës shprehen në terma të përqindjes relacionet e secilës kategori ndaj shumës bazë të tyre të një pasqyre financiare. Kjo analize mbështetet në strukturën e raporteve financiare, me ç'rast pasuria , obligimet dhe ekuiteti

barazohen me 100, ndërkaj të gjitha pozicionet e tjera shqyrtohen në raport me aktivin dhe pasivin e tërësishëm. (Jakupi Dr. Shefket, Statovci Dr. Bedri). Me ndihmën e Excell duke i dhënë formulat për gjetjen e analizës horizontale arrijmë në rezultate më të shpejta. **Formulate përdorura në këtë analizë është:**

$$\text{Analiza vertikale} = \frac{\text{njësia (pjesa e tërësisë)}}{\text{tërësia}} \times 100\%$$

Tabela 9. Tabela e përbashkët e analizës vertikale të Bilancit të Gjendjes

Pozicioni - B.Gj	2017			2018			2019			2020		
Kompanitë	VOLOST ONE (%)	FIMAR (%)	ALMARCO (%)	VOLOST ONE (%)	FIMAR (%)	ALMARCO (%)	VOLOST ONE (%)	FIMAR (%)	ALMARCO (%)	VOLOST ONE (%)	FIMAR (%)	ALMARCO (%)
Aktivitet afatgjatë	30.24	35.25	0	97.51	53.0	84.72	99.25	53.5	88.4	82.83	42.7	93.03
Aktivitet Afatshkurta	69.76	64.75	100	2.49	46.9	15.28	0.75	46.4	11.55	17.62	57.3	6.97
Totali Aktiveve	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kapital	77.83	16.13	100	0.85	46.8	16.28	-2.61	43.2	15.03	-1.95	32.1	11.29
Obligimet	22.17	83.87		99.15	53.1	83.72	102.61	56.7	84.97	101.95	67.8	88.71
Totali	100	100	100	100	100%	100	100	100	100	100	100	100

Në tabelat më poshtë do të shohim analizat vertikale në detaje të secilës kompani veçmas dhe të interpretuara.

Tabela 10. Tabela e përbashkët e analizës vertikale të Bilancit të Suksesit

Pozicioni - B.S	2017			2018			2019			2020		
Kompanit ë	VOLOS TONE (%)	FIMA R (%)	ALM ARC O (%)	VOLOS TONE (%)	FIMA R (%)	ALM ARC O (%)	VOLOS TONE (%)	FIMA R (%)	ALM ARC O (%)	VOLOS TONE (%)	FIMA R (%)	ALMA RCO (%)
Të ardhurat totale operative	100	100	0	100	100	0	100	100	0	100	100	0
Totali i shpenzim eve operative	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Fitimi operativ	100	100	0	100	100	100	100	100	100	100	51.03	100

Në tabelat më poshtë do të shohim veçmas për çdo kompani analizën vertikale të pasqyrës së të ardhurave dhe interpretimin e rezultateve.

3.2.1. Analiza vertikale e Volostone për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit

3.2.1.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Gjendjes

Tabela 11. Bilanci i gjendjes në tregues relativ i ndërmarrjes Volostone

Pozicioni	2016	2017	2018	2019	2020
AKTIVET	%	%	%	%	%
Aktivitet AFATGJATA	0.00	30.24	97.51	99.25	82.38
Aktivitet afatshkurte	0.00	69.76	2.49	0.75	17.62
TOTALI AKTIVEVE	0.00	100.00	100.0	100.00	100.00
Kapitali dhe obligimet					
<i>Kapitali</i>	0.00	77.83	0.85	-2.61	-1.95
<i>Obligimet</i>	0.00	22.17	99.15	102.61	101.95
Obligimet afatshkurte	0.00	22.17	6.39	10.14	21.38
Obligimet afatgjata	0.00		92.76	92.46	80.56
TOTALI KAPITALIT DHE REZERVAVE	0.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi: Përlllogaritje të autorit për qëllimin e hulumtimit

Nga rezultatet e nxjerra konkludojmë që nga aktivet/pasuria më së shumti janë të përfshira aktivet e paprekshme 90.42% në vitin 2019, 89.69% në vitin 2018, paratë e gatshme me 69.7% në vitin 2017, ndërsa tek pasiva/burimet e financimit të mjeteve shohim që në vitin 2017 mjetet janë financuar më së shumti me kapital ndërsa vetëm 22.17% me anë të huamarrjeve. Ndërsa në vitet tjera vijuese 2018,2019 mjetet janë financuar nga huamarrjet me 92,76% dhe 92,46% ndërsa në 2020 me 80% ndërsa pjesa tjetër është mbuluar me anë të kapitalit.

3.2.1.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Suksestit

Tabela 12. Bilanci i suksesit në tregues relativ i ndërmarrjes Volostone

Pozicionet	2016	2017	2018	2019	2020
		%	%	%	%
Të ardhurat totale operative		100.00	100.00	100.00	100.00
Totali i shpenzimeve operative	0	100.00	100.00	100.00	100.00
Fitimi operativ	0	100.00	100.43	99.73	100.02
Të ardhurat totale financiare	0	0.21	0.21	-0.14	0.01
Totali i Shpenzimeve Financiare	0	3.02	9.98	-1.34	19.79
Përfitimi nga aktivitetet e zakonshme	0	97.19	90.24	101.20	80.22

Burimi: Përllogaritje të autorit

Nga tabela e paraqitur, arrijmë të konkludojmë që nga totali i të ardhurave totale operative në vitin 2017 janë të përfshira me 100% të ardhurat e tjera operative ndërsa në vitin vijues 2018 të ardhurat janë 100% kryesisht të realizuara nga tregu i brendshëm poashtu edhe në vitin 2019 ndërsa në vitin 2020 të ardhurat operative janë kryesisht me % më të lartë nga tregu i brendshëm 90.58% ndërsa me përqindje më të ulët nga tregu i jashtëm me 7.90%

Më poshtë janë analizuar dhe shpenzimet si dhe fitimi operativ. Tek shpenzimet vërejmë që për vitin 2017 100% janë të përfshira shpenzimet e tjera nga puna, në vitin 2018 shpenzimet më të larta janë nga amortizimi dhe zhvlerësimi që përfshijnë 83.66% , më pas shërbimet 8.36% si dhe shpenzimet e tjera me 7.92% dhe shpenzimet tjera operative me 0.06%. Në vitin 2019 përqindje më të lartë të shkaktimit të shpenzimeve janë amortizimi dhe zhvlerësimi me 91.37% më pas kostoja e materialeve të konsumuara dhe furnizimeve tjera me 5.61% , shërbimet 1.59% dhe shpenzimet tjera me 1.42%. Në vitin 2020 kryesojnë shpenzimet e shkaktuara nga shërbimet me 66.08% më pas nga amortizimi dhe zhvlerësimi me 28.54% si dhe 5.37% nga shpenzimet e tjera. Sa i përket fitimit operativ nga 100% përfshihen siç vijon:

Në vitin 2017 kryesojnë përfitimet nga aktivitetet e zakonshme me 97.19%, të ardhurat totale financiare 0.21%. shpenzimet totale 3.02%. Në vitin 2018 po ashtu sikurse viti paraprak 0.21% të ardhurat totale financiare, përfshihen 9.98% shpenzime totale financiare dhe 90.24% përfitimet nga aktivitetet e zakonshme.

Në vitin 2019, -0.14% të ardhura totale financiare, -1.34% shpenzime totale financiare ndërsa përfitimi nga aktivitetet e zakonshme 101.20%. Në vitin 2020 0.01% të ardhura totale, 19.79% shpenzimet financiare, 80.22% përfshihen përfitimet nga aktivitetet e zakonshme.

3.2.2. Analiza vertikale e Fimar për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit

3.2.2.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Volostone për Bilancin e Gjendjes

Nga rezultatet e nxjerra konkludojmë që nga aktivet/pasuria në vitin 2016 përfshihen 53.08% aktive afatgjata dhe 46,92% më së shumti me prone,paisje dhe impiante, 46.92% aktive afatshkurte më së shumti me arkëtime tregtare, financimi nga kapitali 3.41% me obligime 96.59% kryesisht obligime afatshkurte. Në vitin 2017, aktivet afatgjate përfshijnë 35.25% me prezenc më të lartë të aktivitetit prona, paisje, impiante, aktivet afatshkurte 64.75% kryesisht me arkëtime tregtare 36.42% më pas me përfshirje më të ulët të inventarit, parat e gatshme, arkëtimet tjera, financimi nga kapitali 16.13% me përqindje më të lartë si rezultat i fitimit të mbajtur dhe financimi me burime të huaja, obligimet 83.87% me përqindje më të lartë të obligimeve tregtare dhe obligimeve tjera afatshkurte për 80.59% si dhe obligimet tatimore të prolonguara, obligimet tjera afatshkurte dhe shpenzimet e përlllogaritura me përqindje të ulët.

Tabela 13. Bilanci i gjendjes në tregues relativ i ndërmarrjes Fimar

Pozicioni	2016	2017	2018	2019	2020
AKTIVET	%	%	%	%	%
Aktivitet AFATGJATA	53.08	35.25	53.07	53.56	42.70
Aktivitet afatshkurte	46.92	64.75	46.93	46.44	57.30
Totali aktiveve	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Kapitali	3.41	16.13	46.83	43.29	32.14
Obligimet	96.59	83.87	53.17	56.71	67.86
Totali i kapitalit dhe rezervat	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

Burimi: Përlllogaritje të autorit

Në vitin 2018, aktivet afatgjate 53.07% me përfshirje më të lartë të aktivit prona, paisje, impiantet, aktivet afatshkurte përfshijnë 46.93% kryesisht me përqindje më të lartë arkëtimet tregtare dhe paratë e gatshme. Kapital 46.83% kryesisht me përqindje më të lartë fitimi I mbajtur, obligime 53.17% kryesisht me përqindje më të lartë obligimet tregtare dhe obligime tjera afatshkurte, shpenzimet e përlogaritura.

Në vitin 2019, aktivet afatgjate 53.56% me përfshirje më të lartë të aktivit prona, paisje, impiantet, aktivet afatshkurte përfshijnë 46.44% kryesisht me përqindje më të lartë arkëtimet tregtare dhe paratë e gatshme, arkëtimet tjera, investimet financiare afatshkurte. Kapital 43.29 % kryesisht me përqindje më të lartë fitimi I mbajtur, obligimet 56.71% kryesisht me përqindje më të lartë obligimet tregtare dhe obligime tjera afatshkurte, shpenzimet e përlogaritura.

Në vitin 2020, aktivet afatgjate 42.70% me përfshirje më të lartë të aktivit prona, paisje, impiantet, aktivet afatshkurte përfshijnë 57.30% kryesisht me përqindje më të lartë arkëtimet tregtare dhe paratë e gatshme. Kapital 32.14% kryesisht me përqindje më të lartë nga rezervat, kapitali nënshkruar, obligime 67.86% kryesisht me përqindje më të lartë obligimet tregtare dhe obligime tjera afatshkurte, shpenzimet e përlogaritura.

3.2.2.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Fimar për Bilancin e Suksesit

Nga tabela e paraqitur më lartë arrijmë të konkludojmë që nga totali i të ardhurave totale operative në vitin 2016 më së shumti dominojnë të ardhurat nga tregjet e huaja të cilët e përbëjnë 75.22% nga totali i të ardhurave operative dhe 24.78% nga tregu i brendshëm.

Tabela 14. Bilanci i suksesit në tregues relativ i ndërmarrjes Fimar

Pozicionet	2020	2016	2017	2018	2019	2020
		%	%	%	%	%
Të ardhurat totale operative	682,466,281	100.01	100.59	100.45	100.01	100.09
Totali i shpenzimeve operative	700,147,072	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Fitimi operativ	-17,680,791	101.06	101.85	100.42	101.90	51.03
Të ardhurat totale financiare	4,329,031	0.53	0.93	0.21	0.95	-24.48
Fitimi neto	-17,465,929					
Fitimi neto Aksionarët e shumicës	-17,465,929					
TOTAL TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE	-17,465,929					

Burimi: Përllogaritje individuale të autorit

Sa i përket shpenzimeve total operative nga 100% përfshihen në përqindje më të lartë kosto e tregtimi të mallrave të shitura me 28.76% më pas shërbimet me 24.48%, më pas kosto e materialeve të konsumuara dhe furnizimeve tjera me 22.67% më pas me 10.60% përfshihen shpenzimet nga amortizimi dhe zhvlerësimi , kostoja e shërbimit 9.98%, shpenzimet e tjera 2.14% dhe me përfshirje më të ulët janë shpenzimet e tjera operative me 1.02%.

Sa i përket fitimit operativ të vitit 2016 të ardhurat totale financiare përfshijnë përqindjen prej 0.53% të fitimit operativ , shpenzimet financiare totale 54%, 46% përfitimi nga aktivitetet e zakonshme.

Në vitin 2017, nga 100% i të ardhurave totale operative shohim se 84.74% e përfshijnë të ardhurat nga tregjet e huaja (shitjet) dhe 15.26 % nga tregu i brendshëm ndërsa me përqindje më të ulët janë të ardhurat tjera operative 0.43% dhe produktet dhe shërbimet e veta të kapitalizuara me 0.17%.

Sa i përket shpenzimeve operative nga 100%, pjesën më të madhe e përfshijnë shpenzimet e tjera me 37.07% më pas shërbimet me 21.75%, Kostoja e tregtimit të mallrave të shitura me 17.16% dhe të tjerat siç janë në tabelë me përqindje më të ulët.

Fitimi operativ me përqindje më të lartë 98.69% nga përfitimi nga aktivitetet e zakonshme ndërsa elementet tjera të cekura në tabel shohim se kanë pjesëmarrje më të ulët në fitimin operativ.

Në vitin 2018, nga 100% i të ardhurave totale operative, 88.90% e përbëjnë të ardhurat nga tregjet e huaja, 15.26% të ardhurat nga tregu i brendshëm dhe 0.17% produktet dhe shërbimet e veta të kapitalizuara ndërsa 0.43% të ardhurat tjera operative.

Sa i përket shpenzimeve operative nga 100%, pjesën më të madhe e përfshijnë kostot e shërbimit me 38.90% më pas kostoja e materialeve të konsumuara dhe furnizimeve tjera me 19.50%.

Fitimi operativ me përqindje më të lartë 98.91% nga përfitimi nga aktivitetet e zakonshme ndërsa elementet tjera të cekura në tabel shohim se kanë pjesëmarrje më të ulët në fitimin operativ.

Në vitin 2019, nga 100% i të ardhurave totale operative, 93.27% e përbëjnë të ardhurat nga tregjet e huaja, 6.73% të ardhurat nga tregu i brendshëm dhe 0.01% të ardhurat tjera operative.

Sa i përket shpenzimeve operative nga 100%, pjesën më të madhe e përfshijnë kostot e shërbimit me 28.25% më shërbimet me 20.09%.

Fitimi operativ me përqindje më të lartë 98.14% nga përfitimi nga aktivitetet e zakonshme ndërsa elementet tjera të cekura në tabel shohim se kanë pjesëmarrje më të ulët në fitimin operativ.

Në vitin 2020, nga 100% i të ardhurave totale operative, 85.18% e përbëjnë të ardhurat nga tregjet e huaja, 14.82% të ardhurat nga tregu i brendshëm dhe 0.09% të ardhurat tjera operative.

Sa i përket shpenzimeve operative nga 100%, pjesën më të madhe e përfshijnë kostot e shërbimit me 29.06% më pas kostoja e materialeve të konsumuara dhe furnizimeve të tjera me 21.59%.

Fitimi operativ me përqindje më të lartë 98.78% nga përfitimi nga aktivitetet e zakonshme ndërsa elementet tjera të cekura në tabel shohim se kanë pjesëmarrje më të ulët në fitimin operativ.

3.2.3. Analiza vertikale e Almarco për Bilancin e Gjendjes dhe Bilancin e Suksesit

3.2.3.1. Analza vertikale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Gjendjes

Nga tabela mund të konkludojmë që për vitin 2017, aktivet janë kryesisht të përbëra nga aktivet afatshkurte konkretisht 100% parat e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe ana e pasives/burimeve të mjeteve janë të përfshira 100% vetëm burimet vetanake konkretisht kapitali i nënshkruar pa marrë hua ose ndonjë detyrim tjetër.

Tabela 15. Bilanci i Gjendjes në tregues relative i ndërmarrjes Almarco

Pozicioni	2016	2017	2018	2019	2020
AKTIVET	%	%	%	%	%
Aktivitet AFATGJATA	0	0	84.72	88.45	93.03
Aktivitet afatshkurte	0	100.00	15.28	11.55	6.97
Totali aktiveve	0	100.00	100.00	100.00	100.00
Kapitali dhe obligimet					
Kapitali	0	100.00	16.28	15.03	11.29
Obligimet	0		83.72	84.97	88.71
Obligimet afatshkurte	0		83.72	84.97	88.71
Totali i kapitalit dhe rezervat	0	100	100	100	100

Burimi: Përlllogaritje individuale të autorit

Në vitin 2018 aktiva e bilancit të gjendjes përfshin 84.72% aktivet afatgjate, konkretisht aktivet e paprekshme, 16.28% aktivet afatshkurte konkretisht paratë e gatshme 14.97%, investimet financiare afatshkurte 0.30% dhe arkëtimet tjera 0.01%. Pasiva/burimet e mjeteve përfshijnë 15.03% kapital dhe 83.72% obligime afatshkurte ku përqindjen më të lartë e zënë huamarrjet afatshkurte dhe vetëm 0.25% përfshijnë obligimet tregtare dhe obligimet tjera afatshkurte.

Në vitin 2019, aktiva e bilancit të gjendjes përfshinë 88.45% aktiva afatgjate konkretisht aktivet e paprekshme dhe 11.55% aktiva afatshkurta konkretisht 10.83% para të gatshme, 0.28% investime financiare afatshkurte dhe 0.44% arkëtime tjera/mjete rrjedhëse. Pasiva/burimet e mjeteve përfshijnë burimet vetanake apo kapitalin me 15.03% ndërsa përqindje më të lartë kanë burimet e mjeteve të huaja me 84.97% ku përqindje më të lartë kanë huamarrjet afatshkurte me 78.47%, shpenzimet e përlllogaritura 5.15%, obligimet tregtare dhe obligimet tjera afatshkurte 1.34%.

Në vitin 2020, aktiva e bilancit të gjendjes përbëhet 93.03% me aktive afatgjate dhe vetëm 6.97% me aktive afatshkurte. Për rrjedhën e aktives në këtë vit sipas tabelës dhe rezultatet që

janë nxjerrë me formulat e përdorura në analizën vertikale për bilancin e gjendjes arrijmë të shohim që 11.29% si burim i mjeteve është përfshirë kapitali dhe pjesa më e madhe është realizuar me anë të obligimeve kryesisht obligimeve afatshkurte 88.71% me përqindje më të lartë që janë huamarrjet afatshkurte.

3.2.3.2. Analza vertikale e ndërmarrjes Almarco për Bilancin e Sukksesit

Tabela 16. Bilanci i Sukksesit në tregues relative i ndërmarrjes Almarco

Pozicionet	2016	2017	2018	2019	2020
	%	%	%	%	%
Të ardhurat totale operative	0	0	0	0	0
Totali i shpenzimeve operative	0	0	100.00	100.00	100.00
Fitimi operativ	0	0	100.00	100.00	100.00
TOTAL TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE	0	0			

Burimi: Përlllogaritje individuale e autorit

Me ndihmën e Excell duke përdorur formulë që është përmendur në analizat e para, janë nxjerrur rezultatet siç vijojnë:

Për vitin 2016 dhe 2017 të dhënat e marra nga bilancet e kompanisë janë të shprehura me 0 në totalin e të ardhurave operative, 0 në shpenzimet totale operative dhe 0 në fitimin operativ.

Për vitin 2018, 0% të ardhura totale operative, nga 100% i shpenzimeve totale operative përfshihen me 100% shpenzimet tjera ndërsa fitimi operativ nga 100% përfshin përqindje më të lartë nga përfitimi nga aktivitetet e zakonshme. Për vitin 2019 poashtu gjendje e njëjtë si vitet paraprake me të ardhurat totale operative, ndërsa për shpenzimet totale operative nga 100% përfshihen 99.52% shpenzimet tjera dhe me përqindje më të ulët 0.48% kosto e materialeve dhe furnizimeve tjera. Ndërsa Fitimi operativ për këtë vit nga 100%, përfshihen me 100% përfitimet nga aktivitetet e zakonshme.

Për vitin 2020 e njëjta gjendje vazhdon me të dhënat e të ardhurave totale siç ishte në vitet paraprake. Sa i përket shpenzimeve totale operative nga 100% me përqindje më të lartë përfshihen shpenzimet tjera 64.03%, më pas amortizimi me 35% dhe shërbimet me përqindje më të ulët me 0.76%. Sa i përket fitimit operativ gjithashtu si vitet më parë nga 100% përqindjen më të lartë e përfshijnë përfitimet nga aktivitete e zakonshme.

3.3. Racio analiza në Minierat e Republikën e Maqedonisë së Veriut

3.3.1. Likuiditeti në sektorin e minierave

Likuiditeti për tre kompanit është llogaritur me formulën **Aktivët rrjedhëse/obligimet rrjedhëse**. Kreditorëve dhe investitorëve u pëlqen të shohin raporte më të larta likuiditeti, si p.sh. 2 ose 3. Sa më i lartë të jetë raporti, aq më shumë ka gjasa që një kompani të jetë në gjendje të paguajë faturat e saj afatshkurtra.

Një raport më i vogël se 1 do të thotë se kompania përballet me një kapital qarkullues negativ dhe mund të jetë duke përjetuar një krizë likuiditeti

3.3.1.1. Likuiditeti i ndërmarrjes Volostone

Tabela e mëposhtme në fillim tregon një raport të kënaqshëm, por shqetësimi është se nga viti në vit shkon duke rënë treguesi i likuiditetit.

Tabela 17. Raporti i likuiditeti për periudhën 2017-2020 për ndërmarrjen Volostone


viti	Aktivët rrjedhëse	Obligimet rrjedhëse	raporti likuiditetit
2016	/	/	/
2017	283,162	90,000	3,14
2018	12,501,464	32,030,821	0.39
2019	3,894,590	52,917,783	0.07
2020	105,620,236	128,183,790	0.82

Burimi: përllogaritje individuale të autorit

Të fokusohemi te vitet 2017 dhe 2020. Në vitin 2017 për çdo denar që kompania duhet të paguajë brenda vitit ka 3.14 den, të cilat mund të shndërrohen në para gjatë vitit, kjo tregon se kompania është mëse likuide, mirëpo në vitin 2020 ky tregues bie në mënyrë drastike dhe për një denar obligim, kompania ka 0.82 den që do të thotë se kompania ka humbur likuiditetin.

Gjithashtu është e paraqitur edhe me anë të grafikut.

Grafikoni 1. Përlllogaritje e likuiditetit e ndërmarrjes Volostone



Burimi: Përlllogaritje individuale të autorit

